



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për rininë”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku, Halil Jakimi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Roland Xhelilaj.

Të pranishëm:

Lorena Haxhiu – Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Zamira Gjini – Drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Florian Nurçe – Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Irsa Ruçi – Drejtore në Shërbimin Kombëtar për Rininë

Matilda Bulku – specialiste në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi

Sot Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë do të shqyrtojë në parim projektligjin “Për rininë”. Relator është Florenc Spaho.

Projektligji ka ardhur nga Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, i cili është komisioni përgjegjës për hartimin e ligjit, ndërsa ne jemi komision për dhënie mendimi.

Të pranishëm nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kemi zonjën Lorena Haxhiu, zonjën Zamira Gjini, drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zoti Erzen Tola, drejtor i Programimit Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, zotin Florian Nurçe, përgjegjës i sektorit të buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, zonjën Irsa Ruçi, drejtore e Shërbimit Kombëtar për Rininë, dhe zonjën Matilda Bulku, specialiste në sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Fjala për zonjën Haxhiu.

Lorena Haxhiu – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sot është një ditë e mirë, sepse kemi ardhur në një moment shumë të rëndësishëm për të gjithë të rinjtë dhe të rejat në Republikën e Shqipërisë, nisur nga rëndësia e përmirësimit të legjislacionit në sektorin e rinisë, por gjithashtu edhe si një kërkesë e vazhduar vitet e fundit nga organizatat e shoqërisë civile, ku u vlerësua si i domosdoshëm hartimi dhe miratimi i një ligji për rininë.

Ky projektligj u përgatit nga një grup pune i posaçëm në bashkëpunim me mbështetjen e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe Olof Palme International.

Shumë shkurt do t’ju tregoj se projektligji synon plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të rinjtë, mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e përputhshmërisë së rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare në këtë fushë, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve qendrore e vendore publike, organizatave që punojnë me dhe për të rinjtë në fushën e rinisë, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë.

Ky projektligj, deri në këtë fazë ku jemi sot përballë deputetëve të parlamentit të Shqipërisë, ka kaluar në të gjithë hallkat konsultative, që parashikon legjislacioni i Republikës së Shqipërisë. Ky proces ka qenë i gjatë, që ka nisur në prill të vitit të shkuar me ngritjen e grupit të punës, për të kaluar te lançimi i projektit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet e të rinjve në korrik të vitit të shkuar. Në këtë konferencë kombëtare kemi bërë bashkë përfaqësuesit në nivel qendror dhe vendor, të cilët kanë kompetenca dhe përgjegjësi për të rinjtë, gjithashtu edhe organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues nga partnerët ndërkombëtarë. Ne kemi punuar të gjithë bashkë për të vendosur ato shtylla kryesore që paraqet edhe dokumenti që keni përpara.

Në tetor të vitit të kaluar ka pasur një tjetër konferencë rajonale me pjesmarrës nga 5 vendet të tjera të Ballkanit Perëndimor, të cilat kanë një ligj për rininë, ku u shkëmbyen eksperiencat e implementimit të projektligjeve përkatëse në vendet e tyre, duke na treguar se cilat ishin sfidat dhe vështirësisë për përmirësimin e kuadrit ligjor, por në të njëjtën kohë duke na ofruar edhe asistencën për bashkëpunim përmes ekspertizës.

Në nëntor kemi nisur një rrugëtim në 12 qarqe të Shqipërisë, ku kemi takuar me mijëra të rinj dhe të reja që vinin nga minoritetet, grupet e marginalizuara, studentë, gjimnazistë dhe 80 organizata rinore. Për këto takime ne kemi një dosje të plotë, të cilën mund t'ua vëmë në dispozicion edhe deputetëve të këtij komisioni, për të treguar çdo koment dhe sugjerim që të rinjtë kanë dhënë për hartimin e këtij projektligji.

Për ta përmbyllur me mendimet nga institucionet qendrore, ne kemi një projektligj të propozuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 281, datë 10.05.2019, "Për rininë" në parim.

Më lejoni të ndaj me ju disa prej shtyllave më kryesore. Ky projektligj përfaqëson një akt të posaçëm ligjor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, përcakton mekanizmat ligjore të fuqizimit të të rinjve, realizimin e pjesëmarrjes së tyre në proceset politikbërëse e vendimmarrëse dhe përcakton veprimtari, të cilat nxisin aktivizimin e të rinjve dhe mbështetjen nga shteti.

Projektligji normon konceptin e hapësirave rinore të sigurt, që është standardi që duhet përmbushur në hapësirat kur të rinjtë mblidhen dhe angazhohen në veprimtari që u përshtaten nevojave të shumëllojshme.

Projektligji rregullon konceptet e edukimit joformal për të rinjtë, një koncept shumë i njohur në të gjitha vendet europiane për rëndësinë e tij, konceptin e punës rinore dhe punonjësit rinorë që në fakt është përshtatur në *acquis*-të e Komisionit European, apo më saktë *soft acquis*, pasi rinia rregullohet me legjislacionin e vendeve përkatëse. Pra, përcakton rolin dhe

përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse, duke ofruar një listë të detajuar nën për nën të detyrave të institucioneve dhe strukturave në nivel vendor e qendror, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtrojnë përgjegjësinë në fushën e mbrojtjes dhe fuqizimit të të rinjve.

Projektligji, gjithashtu, mundëson krijimin e bazës ligjore për dy struktura konsultative që janë: Këshilli Kombëtar i Rinisë dhe këshillat vendorë të rinisë.

Projektligji prezanton institucionin përgjegjës për rininë, i cili duhet të ketë një rol implementues në politikën kombëtare për rininë, gjithashtu edhe një rol shumë të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të njësive dhe strukturave që merren me të rinjtë.

Projektligji rregullon kriteret e organizatave rinore dhe organizatës kombëtare përfaqësuese rinore, parashikon burimet e financimit të politikave, programeve dhe veprimtarive rinore, gjithashtu, rregullon bazën e të dhënave për rininë, përmbajtjen dhe qëllimin e saj për të siguruar informacion të përditësuar për situatën dhe nevojat e të rinjve në mbështetje të planifikimit të mbikëqyrjes dhe vlerësimit të ndikimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor.

Më lejoni t'ju them se për herë të parë në këtë projektligj është definuar grupmosha, pra kush mund të quhen të rinj në Republikën e Shqipërisë. Edhe pse thuhet: “je i ri aq sa ndjehesh”, por në fakt sipas ligjit të rinj janë ata persona që u përkasin grupmoshave 15 deri 29 vjeç. Për këtë jemi bazuar edhe në politikat rinore europiane, në të dhënat e marra nga INSTAT-i, por edhe në kërkimin e dedikuar që kemi realizuar përgjatë këtij procesi të konsultimit të draftligjit me të rinj dhe të reja në të gjithë Shqipërinë, ku UNICEF-i na vendosi në dispozicion mekanizmin “U-Report” për të pyetur të gjithë të rinjtë se cila ishte grupmosha që i përket këtij targeti. Përgjigjja e më shumë se 60% e të intervistuarve ishte 15 deri 29 vjeç.

Ju falënderoj për këtë mundësi dhe mbetemi të hapur për diskutim.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori, zoti Florenc Spaho.

Florenc Spaho – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit zonja zëvendësministre bashkë me stafin e Ministrisë së Arsimit, që keni ardhur këtu!

Dua të sqaroj diçka, projektligji ka për qëllim përcaktimin e veprimtarive të mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon mbrojtje të veçantë për fëmijët dhe

të rinjtë. Në këtë kuadër ky projektligj kontribuon në realizimin e këtij parashikimi dhe të objektivave socialë.

Projektligji synon plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues, që ndikon tek të rinjtë, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes.

Projektligji shërben për përmirësimin e legjislacionit, rritjes së aktivizimit e pjesëmarrjes së të rinjve dhe vendosjes së standardeve për infrastrukturën e shërbimit të të rinjve, duke prezantuar standardin e hapësirave rinore të sigurt.

Miratimi i këtij projektligji do të sigurojë bazën ligjore për një model të ri të përmirësimit të statusit shoqëror dhe të pozitës së të rinjve, si dhe krijimin e kushteve për adresimin e nevojave të të rinjve në të gjitha fushat ku të rinjtë kanë interes.

Ky opsion do të krijojë kushte për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve vetjake dhe shoqërore, si dhe mbështetjen e të rinjve në organizmat e aktivizimeve sociale.

Projektligji parashikon burimet e financimit për politikën, programet dhe veprimtaritë rinore duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim, krahas planifikimeve dhe parashikimeve të buxhetit të shtetit.

Njëkohësisht parashikon edhe burime të tjera të ligjshme financimi, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga veprimtaria e organizatave rinore, donacione, sponsorizime, programe europiane etj.

Në kuadër të financimit, projektligji parashikon financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve, mënyrat e financimit dhe zërat konkretë të financimit. Këto subjekte do të mbështeten në financime nga buxheti i shtetit dhe buxhetet vendore. Projektligji parashikon edhe krijimin e personave juridikë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët do të marrin pjesë në thirrjet e hapura për projektet rinore dhe do të aplikojnë për mbështetje nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Financimi i politikave, programeve dhe veprimtarive rinore, si dhe bashkëfinancimi i politikave, programeve, projekteve dhe veprimtarive rinore planifikohen dhe realizohen nëpërmjet fondeve grant, me synim përmirësimin e infrastrukturës rinore, financimin për ndërtimin e objekteve për rininë, financimin e veprimtarisë së projekteve të organizatave rinore, financimin për anëtarësimin dhe pjesëmarrjen në programe ndërkombëtare, financimin e studimeve, vëzhgimin e analizave të tjera, ku përfutjes të drejtpërdrejtë janë të rinjtë.

Kriteret dhe procedurat për përdorimin e fondit grant, dedikuar për rininë nga buxheti i shtetit për politikën, programet dhe projektet rinore, përcaktohen nga vendimi i Këshillit të Ministrave.

Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin dhe financimin e objekteve dhe infrastrukturës rinore shpërndahet mbi bazën e projekteve që paraqiten nga organizmat e rrjetit rinor, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin vjetor të buxhetit.

Projektet e ndërtimit apo të rikonstruksionit të objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore paraqiten dhe miratohen mbi bazën e procedurave konkurruese të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Miratimi i këtij projektligji nuk mbart kosto të shtuara për buxhetin e shtetit pasi parashikimet financiare për tre vjetët e parë, pra nga viti 2019 deri në vitin 2021, për fondet me burimin e financimit nga buxheti i shtetit janë mbajtur brenda tavaneve të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

Për fondet e parashikuara të pambuluara janë parashikuar financime nga donatorë të mundshëm të OJF-ve ose financime të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe financime të huaja, që kanë mundësi të investojnë për rininë.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar me financim nga fondi grant i buxhetit të shtetit, i dedikuar për rininë, si dhe buxhetet vendore gjatë periudhës tre vjeçare, menjëherë pas miratimit të ligjit, janë fonde që parashikohen të prekin rreth 500 deri në 550 mijë përfitues në të gjithë vendin, nga mosha 15 deri në 29 vjeç.

Kryetar, unë kam dy pyetje për zëvendësministren. Në projektligj propozohen forma dhe kritere për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, të cilat do të jenë persona juridikë jofitimprurës, të cilët krijohen, riorganizohen apo transformohen dhe funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit për organizatat jofitimprurëse. Ndryshimi ndërmjet tyre është se, nëse një nga organizatat konsiderohet si organizatë rinore, në kuptimin e këtij projektligji, duhet të ketë si objekt të veprimtarisë së saj aktivitetin dhe veprimtaritë rinore, ku të paktën 70% e anëtarëve të saj duhet të jenë të rinj, kurse organizata për të rinjtë duhet të ketë të paktën një periudhë 3 -vjeçare, në të cilën duhet të ketë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme projekte dhe programe të reja. Atëherë, qëllimi i këtij projektligji është nxitja e këtyre të rinjve për t’u bërë pjesë e këtyre subjekteve për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të përfituar eksperiencë në fushën e edukimit joformal. Pse tek organizatat për të rinjtë nuk është parashikuar që një përqindje, sado e vogël, e anëtarëve të saj të jenë të rinj? Kjo është pyetja e parë.

Kush do ta miratojë statutin? A duhet të ketë një afat ky miratim? Nëse nuk zbatohet ky afat miratimi, a do të konsiderohet ky statut i miratuar në heshtje nga data e depozitimit të tij?

Faleminderit!

Enver Roshi – Po, mund të përgjigjeni.

Lorena Haxhiu – Faleminderit, për pyetjet!

Nëse lexojmë projektligjin dhe relacionin me shumë të drejtë lind diskutimi se nga janë krijuar dy tipet e organizatave: rinore dhe për të rinjtë.

Së pari, është shumë e rëndësishme të themi se ky projektligj është kuadër, i cili nuk cenon as legjislacionin aktual në Republikën e Shqipërisë, as ligjin “Për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, as ligjin “Për administrimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe as ligjin e posaçëm “Për organizatat jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë”.

Së dyti, qëllimi i këtij projektligji është të definojë organizatat rinore, të cilat si kusht kanë që 70% e anëtarësisë të jenë të rinj. Kjo bëhet për qëllimin e vetëm që ne të nxisim të rinjtë të organizohen dhe të përfitojnë suport të drejtpërdrejtë nga institucionet qendrore dhe vendore. Kuota 70% është vendosur për vetë faktin se në terma praktikë është një lider i organizatës, i cili e themelon atë, por pas X vjetësh ky lider e tejkalon grupmoshën 29 vjeç, si definicionin që të quhet i ri, dhe ky lider nuk mund të përjashtohet as si kontributor fillestar. Kështu që është shumë e rëndësishme që ne t’u hapim rrugën të rinjve që të organizohen. Ndaj, nëpërmjet këtij projektligji ata do të kenë mundësi të regjistrohen nëpërmjet legjislacionit aktual si organizatë jofitimprurëse dhe ky subjekt konsiderohet si organizatë rinore.

Për sa u takon organizatave për të rinjtë, meqenëse anëtarësia është kusht themelor tek organizata e parë, ne nuk mund të përjashtojmë dot as organizatat e tjera, të cilat funksionojnë si shoqata apo fondacione që termin “anëtarësi” nuk e kanë të përmendur. Kështu që, duke mos dashur t’i diskriminojmë, si dhe në të njëjtën kohë duke dashur t’u japim mundësi edhe organizatave të tjera, të cilat nuk punojnë vetëm me rininë, por si fushë të veprimtarisë së tyre kanë të rinjtë, atëherë kushti i vetëm që të quhesh organizatë për të rinjtë, duhet që të paktën në 3 vjetët e fundit të kesh implementuar projekte apo veprimtari, që kanë lidhje dhe ndikim të drejtpërdrejtë tek të rinjtë. Nuk e di nëse isha e qartë.

Faleminderit!

Erzen Tola - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë quhem Erzen Tola, drejtor Juridik në Ministrinë e Arsimit.

Lidhur me pyetjen tuaj për miratimin e statutit, si organizatat rinore, ashtu edhe organizatat për të rinjtë janë organizata jofitimprurëse, të cilat themelohen, regjistrohen në gjykatë dhe funksionojnë sipas ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”. Në këtë këndvështrim, ky ligj nuk mund ta normojë dhe ta rregullojë këtë veprimtari me afate. Pra, organizatat do të themelohen nga themeluesit me vullnet të lirë dhe do të ndjekin procedurat e regjistrimit në

gjykatë dhe, më pas, do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, sipas kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Po, zoti Florenc.

Florenc Spaho – Organizatat e të rinjve janë organizata jofitimprurëse. Grantet, që sigurohen nga qeveria, për këto organizata a janë gjithmonë duke u rritur, duke u subvencionuar, apo janë në të njëjtin nivel?

Faleminderit!

Lorena Haxhiu – Para se t’i jap fjalën ekspertit të buxhetit, më lejoni të bëj një ndërhyrje se një nga vlerat e shtuara që sjell ky projektligj është edhe mundësia që vetë ministria përgjegjëse mund t’u ofrojë të rinjve të organizohen nëpërmjet këtyre subjekteve juridike. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi tani nuk ekziston forma e drejtpërdrejtë e mbështetjes karshi tyre.

Florian Nurçe – Unë jam Florian Nurçe, përgjegjës i Sektorit të Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit.

Risia që sjell ky ligj në fushën e financimit të organizatave është dhënia e fondeve grant. Deri tani nuk ka një fond grant të detajuar dhe qartësisht të përcaktuar për financimin e organizatave rinore, për të rinjtë apo edhe të njësive të vetëqeverisjes vendore me përfitues të rinj në territorin e tyre. Ky fond kombëtar, që do të jetë në Ministrinë e Arsimit apo do të jetë si fond grant për të gjithë të rinjtë, do të marrë formën e plotë ligjore pas miratimit të këtij ligji dhe çdo vit ne do të vendosim edhe tavane për 3 vjet. Për 10 vjetët e ardhshëm ne do të kemi rritje të lartë të buxhetit, duke i lënë hapësirë jo vetëm financimit të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit, por edhe nga njësitë e qeverisjes vendore për aktivitete me përfitues të rinj. Gjithashtu, do të ketë edhe fonde të tjera të ligjshme nga donatorët, të cilat organizatat do t’i aplikojnë në projekte europiane, projekte rajonale apo ndërkombëtare, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe financimin e tyre, përmirësimin e kushteve të akomodimit në vendet ku do të zhvillohen këto aktivitete, si në mjediset për argëtim, biblioteka, laboratorë, kudo ku jetojnë të rinjtë, duke iu krijuar akses jo vetëm organizatave të të rinjve, por edhe njësive të qeverisjes vendore që të aplikojnë për të fituar projekte nga këto fonde.

Faleminderit!

Enver Roshi - Unë e vlerësoj ligjin si një risi, sepse është hera e parë, që është paraqitur një ligj për rininë në të gjitha vitet e demokracisë. Nuk dua të futem në brendësi të avantazheve që sjell ky ligj, por vë re se ka një fashë për moshat 24-29 vjeç. Unë besoj se nevoja më emergjente e kësaj grupmoshe, pra 24-29 vjeç, është punësimi. Në njërën anë, në

administratën shtetërore ka vite të tëra që shtyhet mosha e pensionit me 1, 2 apo 3 vjet, dhe, nga ana tjetër, ka një presion të vazhdueshëm tek të rinjtë, të cilët mbarojnë universitetin dhe nuk gjejnë vende pune. Si mund të rregullohet kjo gjë?

Problemi i punësimit është problemi më emergjent i të rinjve. Unë e kuptoj se këtu bëhet fjalë për zhvillimin profesional, për kushte më të mira për rininë, por këtu duhej të ishte edhe një nen i veçantë që t'i promovonte apo të gjendeshin hapësira se si këta të rinj të futen në tregun e punës. Gjithashtu, edhe grupmosha mbi 65 vjeç e lart ndodhet në kushtet e një presioni të madh në administratë, sepse, për shkak të eksperiencës, ata duhet të qëndrojnë ende në punë. Çfarë do të bëhet me këta të rinj, të cilët kanë nevoja jetike për punë për të mbajtur familjen e të tjera me radhë?

Së dyti, në lidhje me planifikimin e kuotave në universitete, kam vënë re se shumë fakultete bëjnë propozime për studentë në disa degë, të cilat ose kanë treg shumë të pakët, pra që nuk zënë një vend pune, ose janë jashtë mundësive të punësimit. Unë mendoj se Ministria e Arsimit bashkë me rektoratet dhe universitetet duhet të kenë një vlerësim të tregut të punës për të gjitha kuotat e pranimeve në universitete, në mënyrë që të mos krijojmë papunësi, që të rinjtë të mos humbasin 5 vjet në këto fakultete dhe më pas të enden rrugëve, pa pasur një punë të garantuar. Para 3 vjetësh Ministria e Arsimit e ka mbyllur degën e Shëndetit Publik në Fakultetin e Mjekësisë për shkak se tregu i punës u godit nga qeveria, duke sjellë një numër të madh studentësh, ku, megjithëse, ne kërkonim 20 kuota, qeveria e mëparshme solli 70, 80 apo 100 studentë në vit. Prandaj, ne duhet të jemi të kujdesshëm që në ligjin për rininë të shikojmë mundësinë edhe të tregut të punës, sepse është emergjente. Ne e dimë që qendrat kulturore janë një mundësi e mirë për zhvillimin profesional dhe edukimin kombëtar, por punësimi është problem më emergjent. Prandaj, ju në radhë të parë dhe qeveria duhet të siguroni që kjo gjë të garantohet apo të gjenden hapësira se si mund të ndihmojmë në punësim.

Së treti, nuk është nevoja që këtu të përdorim disa përkufizime në gjuhë të huaj, por mund t'i përkthejmë në gjuhën shqipe. Për shembull, shprehjes "subsidiarity" mund t'i gjejmë një fjalë shqip. Ajo që mua më shqetëson më shumë dhe më duket më problematike, më kritike dhe më emergjente është grupmosha 24-29 vjeç, të cilën ju e keni përmendur se janë të punësuar apo që janë punëkërkues. A mundet që ky projekt t'u vijë në ndihmë një grupi të rinjsh, të cilët, pasi kanë mbaruar fakultetin dhe nuk janë të punësuar, duan të krijojnë një ndërmarrje të tyre? A mundet që vetë shteti t'i ndihmojë ata me taksa, në mënyrë që këta të rinj të kenë fuqi zhvilluese?

Natyrisht, mua më shqetëson pjesa universitare në aspektin e planifikimit real të kuotave dhe, nëse do t'i shikonim të gjitha universitetet me radhë do të gjejmë degë që nuk

ekzistojnë. Për shembull, ka shumë studentë që kanë mbaruar për logopedi, të cilët sot nuk kanë ku të punojnë; ka fizioterapistë, të cilët nuk kanë ku të punojnë; ka me dhjetëra imazheristë apo radiologë, të cilët nuk kanë ku të punojnë. Atëherë, pse duhet t'i gënjejmë studentët? Nëse ka treg pune për infermierë apo mjekë, atëherë jepuani këtyre fakulteteve atë numër kuotash, në mënyrë që nëpërmjet pranimeve të kuotave në universitete të mos krijojmë më pas papunësi.

Unë mora si shembull këto për të cilat kam dijeni, por, nëse do t'i analizojmë të gjitha universitetet me radhë, mund të them se kanë shumë problematika të këtij lloji. Këto ishin disa gjëra që mua vërtet më shqetësojnë. Natyrisht, është hera e parë që vjen një ligj i tillë, të cilin do ta vlerësojmë dhe do ta përmirësojmë, dhe nuk e shikoj të arsyeshme që të mos e kalojmë, por duhet t'i marrim parasysh këto gjëra.

Faleminderit!

Ardiana Jaku - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, kur vjen çështja për të biseduar dhe për të diskutuar, gjëja e parë që të vjen në mendje është shkollimi, edukimi dhe, pa diskutim, punësimi. Gjendemi para faktit që na vjen në tryezë për herë të parë një ligj i dedikuar për rininë. Në fakt, mbështetja për rininë duhet konceptuar më gjerë se si t'i angazhojmë ata, përpos edukimit dhe punësimit. Kështu që unë i çmoj me vlerë disa gjëra që ky ligj përcakton, për shembull, siç janë punonjësit rinorë, ku është specifikuar se duhet të jenë punonjës të dedikuar, të cilët do të merren me çështjet e rinisë pranë pushtetit vendor dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Gjithashtu, janë specifikuar edhe strukturat konsultative, por, gjithashtu, edhe institucionet përgjegjëse se si do t'i ndajnë detyrat dhe si do t'iu dedikohen të rinjve, dhe kjo është për t'u përgëzuar.

Nga ana tjetër, më vjen shumë mirë që për herë të parë ky ligj mundohet të rregullojë organizatat që merren me çështjet e të rinjve ose për të rinjtë. Gjatë të gjithë këtyre viteve kam pasur mundësinë të punoj në shoqërinë civile dhe ajo që kam hasur vazhdimisht është që për të njëjtin target grup në zona të ndryshme, në lokalitete të ndryshme kanë ardhur të njëjtat projekte për të njëjtët përfitues, pra pa i maksimizuar efektet dhe pa e shtrirë gamën e përfituesve. Më vjen mirë që i dedikohet një vëmendje e veçantë punës që do të bëjnë organizatat dhe monitorimit të punës së tyre se shpeshherë na del nga fokusi, kjo jo vetëm për rininë, por edhe për target grupet e tjera në të cilat punojnë organizatat e shoqërisë civile.

Pyetja ime është si do të mbështetet pushteti vendor lidhur me buxhet me financim për të ngritur dhe fuqizuar sektorin e rinisë? Ne e dimë që pushteti vendor ka njëmijë halle. Sot ne vijmë nga fushata elektorale dhe i kemi hasur vështirësitë në zonat përkatëse, kështu që të flasësh për përfshirjen e të rinjve dhe angazhimin e tyre duket pak në vëmendje të dytë për pushtetin vendor.

Si ka menduar ta mbështetë pushtetin vendor Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve për ta bërë të efektshëm këtë ligj? Në fund të ditës ne jemi shumë dakord që të kemi ligje të dedikuara për grupe të ndryshme, por duam të shohim impaktin që do të ketë në terren. Për ne është e rëndësishme, për mua gjithashtu, që të rinjtë e Lezhës të dinë ku të trokasën, të dinë që, nëse bëhen bashkë për një projekt të caktuar, që e kanë vëmendjen e ministrit dhe të pushtetit vendor, por si duhet t'i mbështesim financiarisht kur vjen puna për ta implementuar një projekt të caktuar?

Klodiana Spahiu— Ju në fjalën tuaj përmendët si ka ardhur deri sot ky ligj për miratim, përmendët një punë të vazhdueshme që keni bërë në takimet me rininë, por, gjithashtu edhe kontributin e shoqërisë civile ose të organizatave rinore.

Pak më parë ishim bashkë në Komisionin e Integritetit, ku u diskutua në parim ky projektligj dhe besoj se ju do t'i merrni parasysh meqë ne jemi ende në diskutimin në parim. Ju duhet të merrni parasysh edhe disa nga propozimet e organizatave rinore.

Ne kemi punuar vazhdimisht për buxhetimin rinor, a mund të bëhet e njëjta gjë për rininë dhe të ecim paralelisht me këtë gjë që secila ministri të ketë një zyrë më vete dhe të merret aq sa ka fokusin e saj me buxhetimin për rininë? Kjo do të ishte një gjë shumë pozitive.

Së dyti, ky është një ligj kuadër dhe nuk besoj se rregullon punësimin, por do të jetë ndërthurja e ligjeve me njëri-tjetrin, siç kemi kaluar ligjin për punësimin, ku u jep zgjidhje një sërë problematikash të rinisë shqiptare sot.

Nuk pashë në këtë projektligj ndonjë fokus për të rinjtë me aftësi ndryshe. Do të doja që të fokusoheshit, sepse janë të shumtë në numër dhe ne, si Komision Shëndetësie, na takon të fokusohemi te ky grup, t'i japim mbështetje për të qenë edhe ata të barabartë me moshatarët e tyre, në fonde dhe mbështetje me projekte. Kjo gjë duhet theksuar në një nga nenet.

Gjithashtu, ju në projektligj përmendni pushtetin vendor se si do të mbështesë rininë. Tashmë me miratimin e ligjit do të ketë një përfaqësi të veçantë për rininë në çdo bashki, e cila do të merret me mbështetjen e rinisë për ta orientuar me projekte. A mendoni ju se ka ardhur momenti që ne të kemi një kuotë të caktuar edhe për rininë në këshillat bashkiakë? Sepse, nëse ne po miratojmë një ligj për rininë, besoj se zëri i tyre duhet të dëgjohet kur ata kanë përfaqësues në këshillat bashkiakë. Kemi përpara modele të vendeve të ndryshme, të cilat disa e kanë dhe disa nuk e kanë ligjin për rininë, por e kanë të përfshirë në ligje të ndryshme. Ju keni marrë si shembull besoj ligjet për rininë që kanë vendet e rajonit Serbi ose Mali i Zi. Si e kanë ato? Pra, ju jeni munduar t'u përshtateni atyre? Unë do të doja shkurtimisht opinionin tuaj që ne, kur ta miratojmë këtë projektligj, të kemi mbështetjen e të gjithë kolegëve, por edhe të organizatave rinore.

Halit Valteri – E nderuara zëvendësministre, nga i gjithë ky projektligj do të doja të mbështesja edhe kolegen, nuk pamë asnjë rresht për shtresat e marginalizuara. Të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë me vështirësi ekonomike, komuniteti rom dhe egjiptian, janë lënë pas dore 30 vjet dhe milionat e eurove që kanë ardhur në këtë vend nuk kanë marrë drejtimin e duhur për këto shtresa.

Një shqetësim tjetër është edhe grupmoshën 24-29 vjeç. Shikoj këtu që thuhet se janë 200 mijë të tillë, që janë punëkërkues ose të punësuar për të cilët duhet të kemi një lloj statistike se sa punëkërkues janë dhe sa të punësuar, sepse nuk mendoj se 200 mijë të rinj në Shqipëri janë të punësuar, e them me bindje të plotë se 10 ose 20 % janë të punësuar, kurse pjesën tjetër i sheh nëpër kafene, se këtu jetojmë.

Siç tha kolegja, kur kthehem nga fushata elektorale shohim që i vetmi problem në këtë vend është që duhet të ikin jashtë shtetit, se nuk ka një vend pune të sigurt dhe nuk e përballojnë dot jetesën e shtrenjtë në Shqipëri.

Unë kisha një sugjerim për këto grupmosha. Këto projektligje janë shumë të mira, por i kushtojnë miliona euro buxhetit të shtetit, nuk është se janë pak lekë, sepse, që të mbështesësh një grupmoshë do të thotë se do të paguash. Ato projekte kushtojnë dhe ne e dimë shumë mirë se sa projekte janë marrë dhe janë lënë në mes të rrugës.

Zëvendësministre, do t'ju sugjeroja që t'i mbështesni këta të rinj, sepse sapo dalin nga shkolla duhet që qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, t'u rimbursojë përqindjen e kredisë dhe jo t'i falë lekët, për nxitjen e biznesit për profesionet e lira, sepse është mbushur me juristë, me avokatë e me ekonomistë. Tek e fundit, katedra e matematikës ka tri studentë sot. Duhet të bëni një ligj që të nxisni në mënyrë ekonomike këtë njerëz, me qëllim që ata të shkojnë drejt auditorëve të shkollave dhe këtyre profesioneve që janë lënë! 150 mijë janë për moshën 19-23 vjeç, që do të thotë se sa mbarojnë gjimnazin futen në fakultet. A ka mundësi t'i nxisni qoftë edhe me pagesë, se e gjithë bota me pagesë e ka? Nuk do të jetë ndonjë lekë shumë i madh që do t'u jepni 150 mijë studentëve në 4 vjet, se një herë në 4 vjet bëhet projektligji. Ky ligj prek të gjithë shqiptarët, ata që kanë marrë valixhet dhe kanë ikur dhe ata që enden rrugëve ose duke punuar nëpër *call center*. Rinia shqiptare punon në *call center*, jo se është turp të punosh atje, se është profesion me djersën e ballit, por nuk mund të priremi drejt *call center*-ave, telefonatave. Ne duhet të nxjerrim inxhinierë, matematicienë, fizikantë, profesionistë në fusha në ndryshme, sepse kjo shoqëri po vdes, po largohet. 3000 infermierë dalin në vit dhe 2000 na i merr Gjermania, nuk është keq që po na i merr, por ne kemi këtu nevojë. Kryetari i komisionit tha që të mos i shtyjmë vitet e pensionit, pra shkove 65 vjeç, mbylle atë pjesë, sepse është ai 25-vjeçari që po rri aty dhe pret të hyjë në punë. Fute në punë që 22 vjeç të rrijë praktikant me

një rrogë! Ministria përkatëse le t'i japë rrogë nxitëse! Nëse duam të bëjmë një ligj për rininë, duhet ta nxisim atë ekonomikisht, që ta mbajmë këtu dhe të mos largohet.

Faleminderit!

Florenc Spaho – Faktikisht, edhe ju kryetar e prekët, ashtu sikurse dhe kolegu parafolës që pjesa më e ndjeshme është punësimi i të rinjve, qoftë i atyre që sapo kanë mbaruar gjimnazin, apo që kanë shkuar në shkolla profesionale, qoftë ata që kanë mbaruar shkollat e larta. A ka ndonjë bashkëpunim me Ministrinë e Financave, se të gjitha bizneset kërkojnë profesionistë me eksperiencë, por kur janë të rinj ku do ta gjejnë eksperiencën? A ka ndonjë bashkëpunim me ministrinë se si mund t'u krijohet lehtësi këtyre bizneseve, qoftë edhe në taksa, me qëllim që t'i punësojnë rinjtë dhe ata të fitojnë eksperiencë, se në qoftë se të gjithë do të kërkojnë punë në shtet, shteti nuk i plotëson dot aq sa duhet vendet e punës. Kështu që bizneset janë bashkëpunëtorë shumë të mirë dhe duhet t'i shohim si aleatë në këtë rast, por duke pasur edhe një bashkëpunim me Ministrinë e Financave, qoftë për profesionet e lira, që i përmendi edhe kryetari, fizioterapi, logopedi, imazheri apo edhe shkollat profesionale, për ata që kanë mbaruar për hidraulikë, saldatorë, zanate me të cilat mund të punohet në biznese të vogla, duhet t'i krijohet lehtësi biznesit, sepse nuk ka ku ta gjejë eksperiencën i riu që sapo ka mbaruar shkollën.

Faleminderit!

Enver Roshi – Doja që diku të futet edhe *internship*-i dhe të bëhet i detyrueshëm për institucionet shtetërore.

Fjala është për ju. Besoj se e mbajtet shënim këtë punën e *internship*-it, sepse ka shumë probleme me mospërfshirjen e studentëve në *internship*-e.

Lorena Haxhiu – Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Shqetësimet tuaja janë me shumë vend.

E nisa fjalën time duke thënë që ky ligj, përveçse është në përputhje të plotë me legjislacionin aktual të Republikës së Shqipërisë, synon të plotësojë edhe kuadrin ligjor, që lidhet drejtpërdrejt me të rinjtë në vendin tonë. Kështu që një pjesë e mirë e pikave, që u diskutuan këtu, rregullohen me ligje të posaçme (kujtojmë këtu ligjin për nxitjen e punësimit, ligjin për arsimin profesional, ligjin e vullnetarizmit e të tjerë).

Në mënyrë që të mos ketë mbivendosje, por të ketë një harmonizim, le të themi, janë parashikuar mënyrat e financimit në formën më specifike, si për institucionet qendrore, ashtu edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Konkretisht, në nenin 5 të projektligjit parashikohen kompetencat e Ministrisë përgjegjëse për Rininë dhe në nenin 6 parashikohen kompetencat e

institucioneve të tjera qendrore, ku në germën b, thuhet: “Të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të të rinjve”.

Sigurisht, janë me shumë vend ndërhyrjet, për sa kohë rinia është një fushë ndërsektoriale dhe nuk mund t’i përkasë vetëm institucionit përgjegjës. Ky ligj do të ndikojë që edhe institucionet të jenë në harmoni me politikën dhe implementimin e tyre.

Ky ligj nuk mund të zbatohet pa aktet nënligjore, por nuk mund të zbatohet as pa strategjinë e re kombëtare, të cilën do ta miratojmë së shpejti, sepse plani kombëtar i veprimit për rininë përfundon në vitin 2020.

Përmes objektivave të qarta, ky plan ka pasur 6... Ne do të shikojmë mundësinë që strategjia e re të jetë e shtrirë në kohë, me një afat 10-vjeçar. Do të përqipemi t’i përmbushim këto objektiva përmes financimit të drejtpërdrejtë të të rinjve të organizuar, të cilët nuk janë vetëm nga grupet e marginalizuara apo minoritetet. Në këtë ligj, shprehimisht, thuhet se qëllimi ynë është gjithëpërfshirës.

Për sa i takon pjesës së punësimit (me shumë vend), më lejoni t’ju kthej në vëmendje një program të suksesshëm të qeverisë shqiptare, siç është programi kombëtar i praktikave të punës. Kemi mbërritur në thirrjen e katërt të tij. Ky është një program që ndahet në dy faza.

Faza e parë e programit apo qëllimi kryesor i tij është ofrimi i një përvojë kualifikuese për të gjithë të rinjtë nga 21-26 vjeç, që kanë mbyllur të paktën ciklin e parë *bachelor* të studimeve, në mënyrë që t’i qasen administratës publike dhe të përfitojnë këtë përvojë pune, fillimisht me afat 3-mujor, të certifikuar nga Departamenti i Administratës Publike. Më pas, 200 më të mirët në nivel kombëtar, ndërministror, do të punësohen me kontratë 1-vjeçare. Jemi në prag të punësimit të 200 të rinjve të tjerë, përmes thirrjes së katërt të këtij programi.

Vit pas viti e kemi zgjeruar këtë program. Kjo rregullohet me një vendim të posaçëm të qeverisë. E kemi zgjeruar këtë program, jo vetëm në nivel ndërministror, por duke u shtrirë edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në shoqëritë tregtare.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë sot ka marrëveshje ekskluzive me secilin nga këto institucione, ku inkurajon dhe nxit punësimin e të rinjve. Sigurisht, shifrat mund t’jua bëjmë publike në momentin kur do t’i kemi, pas koordinimit të kësaj thirrjeje.

Një tjetër aspekt që dua të rikthej në vëmendjen tuaj është punësimi i ekselentëve. Të gjithë të rinjtë, të cilët kanë përfunduar ciklin e parë apo të dytë të studimeve me mesatare 9 deri në 10, fasha është zgjeruar, edhe pa pasur eksperiencë pune, janë punësuar sot në administratën publike dhe shërbejnë si resurse shumë të rëndësishme. Ne jemi në situatën fito-fito, sepse ne fitojmë nga energjia e tyre, nuk dua ta ndaj veten nga ata, sepse i përkas ende

fashës dhe moshës së re, por në të njëjtën kohë ata përfitojnë një përvojë të parë dhe shumë të rëndësishme për t'u integruar në tregun e punës.

Gjithashtu, më pas do t'ia lë fjalën edhe ekspertëve të paktit për universitetin. Ekziston sistemi i patronazhit ku ministrinë e linjës në bazë të profilin të tyre kanë patronazhuar tanimë universitetet dhe fakultetet publike në Republikën e Shqipërisë dhe në këtë të mënyrë studentët kanë mundësi të qasen më pranë praktikave profesionale. Kjo do të thotë se sot studentët kanë hapësira për të realizuar praktika dhe kjo jo vetëm nëpër ministri, por ministrinë do të ndërmjetësojnë edhe praktikat profesionale në shoqëritë tregtare që përputhen me profilet përkatëse.

Pa u zgjatur më tej po ua kaloj fjalën zotit Tola dhe zotit Nurçe për plotësimin e pyetjeve të tjera.

Faleminderit!

Enver Roshi – Fjalën e ka zoti Tola.

Erzen Tola – Faleminderit, zoti kryetar!

Sa i takon çështjes së kuotave, që ju ngritët, dua t'ju them se Ministria e Arsimit tashmë prej disa vitesh ka një politikë shumë të qartë për këtë çështje. Me miratimin e ligjit për arsimin e lartë dhe vendosjen e notës mesatare është bërë realisht një hap përpara drejt vlerësimit të të gjitha programeve të studimit, si dhe të përcaktimit të numrit të kuotave dhe të studentëve që shkojnë në çdo program studimi. Ky është hapi më i rëndësishëm, të cilin ne do ta monitorojmë në vijim, edhe pse situata po shkon drejt përmirësimit.

Faleminderit!

Florian Nurçe – Për disa nga pyetjet që u bënë nga zotërinjtë deputetë dua t'ju sqaroj se kuotat në arsimin e lartë pas miratimit të ligjit të ri i marrin vetëm organet kolegjiale të universiteteve. Ministria vlerëson standardet infrastrukturore, akademike dhe financiare dhe çdo e drejtë për të hapur apo për të mbyllur programe varet nga organet kolegjiale të universiteteve publike apo private.

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon pyetjes se si do të financohen njësitë e qeverisjes vendore për projekte me përfitues të rinjtë, ne tashmë kemi krijuar një program se si aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore për të përfituar fonde për infrastrukturën me përfitues nxënësin dhe me përfitues të rinj.

Miratimi i këtij ligji do të sjellë synimin dhe misionin që këto projekte të jenë me përfitues të rinjtë dhe të mos kenë karakter me përfitues nxënësit, studentët, por do të jenë vetë të rinjtë. Pra, do të jetë jo vetëm krijimi i kapaciteteve të infrastrukturës shkollore, por do të

ketë edhe ambiente për argëtim, për shplodhje, biblioteka, mjedise sportive, të cilat nuk janë në kurrikul dhe programin mësimor.

Në këtë mënyrë të rinjtë do të mësojnë se si të shkruajnë projekte, kur të punësohen në të ardhmen, të cilat do të jenë në gjendje t'i hartojnë vetë.

Pyetja tjetër ishte nëse mund të krijohen njësi, entitete për t'u punësuar apo vetëpunësuar. Ky ligj nuk e ka këtë, por krijon akses për të realizuar projekte dhe për të krijuar, kurse ligji për nxitjen e punësimit ka të tjera incentiva dhe mund t'ju ofrojë më shumë. Nëse vijmë te shtresat sociale në nevojë, që janë romët dhe egjiptianët, po ju them se ka ligje të tjera specifike, të cilat kanë në fokus romët dhe egjiptianët, siç është ligji për arsimin parauniversitar, ligji për arsimin profesional, ligji i arsimit të lartë, siç dhe ka vendime të Këshillit të Ministrave ku romët dhe egjiptianët marrin bursë, tekste falas, u hiqen tarifat e shkollimit dhe në universitete kanë kuota, ku veç programit për reference, ky program, i përjashton, por ata kanë akses që jashtë këtij programi të shkojnë në universitet dhe të marrin kuota preferenciale në degë të zgjedhura, të cilën me postulatit meritë-preferencë nuk mund ta arrijnë dot.

Pra, për këtë arsye ministria ka nxjerrë një udhëzim të caktuar dhe ata kanë avantazhe shumë pozitive karshi maxhorancës.

Faleminderit!

Enver Roshi – Po, zoti Spaho, ju lutem shkurtimisht!

Halit Valteri – Kisha diçka për zotin Nurçe. Të gjitha këto që ju sapo na thatë janë shumë të bukura në letër, por realiteti në këtë vend është komplet ndryshe nga ato që ju thoni. Sot, romët dhe egjiptianët nuk kanë asnjë të drejtë të pjesa e studimit, tekstet falas ekzistojnë vetëm nëpër letra dhe në realitet ata nuk i marrin...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbaroj fjalën, mos më ndërhyini!

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse nuk ju intereson kjo temë po e mbyll diskutimin.

Pyetja që unë kam është: më jepni një statistikë se sa romë janë përfshirë në këtë program?

(Diskutime pa mikrofon)

Ervis Meço – E përshëndes nismën dhe shumë shkurt dua të ndaloj në disa gjëra meqë jam njohës i mirë i dy minoriteteve më sensitive në Shqipëri. Është pak ironike, sepse nuk ka ligje të gabuara, por ka ligje të mira me praktika të gabuara. Me aq sa unë kam dijeni, janë 1200 studentë, shumica e tyre kanë dy fakultete si nga romët, ashtu edhe nga egjiptianët. Për të gjitha këto praktika ndoshta nuk është vendi këtu, por niveli i punësimit të tyre është zero. Meritë-

preferenca, konkurset, projektet janë një ironi, pasi disa nga gjërat që ata trajtojnë kur mbledhemi nëpër simpoziume të përbashkëta është fakti që shteti në nivel qendror dhe lokal, pa specifikuar asnjë ministri, lançon projekte dhe maxhoranca vjen sërish dhe na jep leksione pas 28 vjetësh. Unë mendoj se kjo gjë duhet parë, sepse drejtpërsëdrejti është një diskriminim absolut.

Idea ime është se si mund të operojmë në një mënyrë më transparente, më të thjeshtë dhe më të dukshme, duke qenë se kemi të bëjmë specifikisht me një nga pesë kriteret për të hyrë në Bashkimin Europian, kjo qeveri duhet të përmbushë. Të vijmë me dinjitet, të trajtohen me dinjitet dhe atë fond të caktuar për atë projekt 6, apo 9 mujor që përcaktohet ta rimarrin drejtpërdrejt ata. Në dijeninë time janë mbi 360 shoqata rome egjiptiane, jo të gjitha meritojnë respektin e duhur për sa i përket anës ligjore dhe asaj dinjitoze për të trajtuar një projekt, por sot ka shumë studentë që i kanë të gjitha bazat ligjore dhe aftësitë, duke u shtrirë në të gjithë Shqipërinë për ta rimarrë këtë projekt. Ky është sugjerimi im që maxhoranca të mos i marrë këto projekte dhe t'u japë leksione pas 28 vjetësh, pasi këtë gjë ata mund ta bëjnë vetë me njëri-tjetrin.

Shqetësimi që kam hasur personalisht ka të bëjë me tarifat e masterit, që nga viti 2013 është lançuar i gjithë projekti për shtresat në nevojë, që në pamundësi ekonomike të përfitojnë si mundësi integrimi subvencionimin monetar nga shteti për arsimimin e tyre. Kemi hasur në një diskriminim dhe në një ngërç total që në fund të fundit, për ta mbyllur në një formë kontrasti qeveria u jep mundësinë e *bachelorit* falas 100% dhe po përsëri kjo qeveri ka një ligj të posaçëm, nuk më kujtohet neni, që asnjë individ me *bachelor* nuk ka mundësi ta aplikojë punësimin në shtet pa pasur master, që do të thotë se qeveria u jep mundësinë e integritit këtyre dy minoriteteve me *bachelor* dhe në të njëjtën kohë ua heq mundësinë e masterit apo ua jep gjysmë për gjysmë. Në pamundësi totale ekonomike shumë studentë në dyvjeçarin e fundit e kanë lënë masterin. Pra, do të doja që të rishikohet çështja e tarifës së masterit.

Enver Roshi - Faleminderit!

Besoj se i mbajtët shënim këto gjëra.

(Ndërpritet regjistrimi)

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për rininë”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku dhe Halil Jakimi.

Mungojnë:

Klotilda Bushkaj.

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrera - Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho - Kryeinspektore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Orjola Shahaj – Këshilltare në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Enver Roshi - Fillojmë mbledhjen. Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”. Komisioni përgjegjës jemi ne. Relatore është zonja Bode.

Të pranishme kemi ministren, zonjën Manastirliu.

Zonja Manastirliu fjala është për ju.

Ogerta Manastirliu - Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot do të paraqesim para jush propozimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sa u përket disa ndryshimeve ligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar”.

Ky është një projektligj, i cili është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me qëllim mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit dhe forcimin e monitorimit të duhanpirjes në ambientet publike. Përpara se të prezantoj ndryshimet që ne propozojmë, më lejoni të sqaroj që në fillim se ndryshimet në këtë projektligj janë hartuar në frymën e direktivës 40/2014 të BE-së, si dhe të Konventës kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për kontrollin e duhanit, të cilat janë konsultuar edhe me të gjitha grupet e interesit. Gjithashtu, në kuadër të konsultimeve Komiteti Ndërmintor për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit ka pasur një rol të rëndësishëm në diskutimin e të gjitha ndryshimeve ligjore të propozuara, me qëllim forcimin e kontrollit dhe ruajtjen e shëndetit nga duhanpirja. Ne i çmojmë shumë të domosdoshme këto ndryshime që vijnë, jo vetëm për të përmirësuar kontrollin e duhanpirjes, por edhe për të dekurajuar pirjen e duhanit të moshat e reja, si dhe për të reduktuar akoma më shumë duhanpirjen në tërësi, pasi sikurse është e njohur tashmë duhanpirja është 1 ndër 3 faktorët madhorë të riskut për sëmundjet kronike në Shqipëri, të cilat përbëjnë edhe shkaku kryesor të vdekjeve dhe të paafësisë. Sot, 4 vjet pas ndryshimeve të fundit në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve nga produktet e duhanit” mund të themi me siguri se forcimi i mekanizmave të implementimit të ligjit në atë kohë, solli rezultate shumë pozitive, ku Shqipëria, Ministria e Shëndetësisë ka marrë një medalje nga OBSH-ja për arritjet që pati në instrumentet e monitorimit të ligjit “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, por sigurisht që të gjitha këto instrumente të përdorura në kuadër të ligjit, puna voluminoze që është bërë në kuadër të zbatimit të këtij ligji, na orientojnë drejt përmirësimeve të duhura, të cilat duhet t’i ndërmarrim sa më shpejt me qëllim jo vetëm

përafrimin me direktivën europiane, përmirësimin e instrumenteve ekzistues ligjore dhe përfshirjen e elementeve të reja në këtë ligj, të cilat do të rrisin kontrollin ndaj duhanpirjes.

Dua t'u jap disa rezultate për t'ju treguar sesi janë përmirësuar disa indikatorë të rëndësishëm në studimin demografik dhe shëndetësor të realizuar në vitin 2018 që tregon se prevalenca e duhanpirjes te meshkujt në Shqipëri ka ardhur në ulje në 10 vjetët e fundit. Aktualisht në Shqipëri 36% e meshkujve të moshës 15-49 vjeç janë duhanpirës ose e thënë ndryshe 1 në 3 meshkuj të kësaj kategorie janë të ekspozuar ndaj një prej faktorëve, ndaj duhanpirjes në Shqipëri.

Megjithatë, këto shifra tregojnë për një prevalencë ende të lartë. Prandaj, në strategjinë kombëtare të shëndetësisë, ne synojmë që deri në vitin 2020 ta reduktojmë duhanpirjen në popullatën shqiptare në masën nën 30 %.

Pra, bazuar në objektivat strategjike, të vendosura në strategjinë kombëtare të shëndetësisë, por edhe në të gjitha aspektet e përmirësimeve që ne duam të arrijmë edhe për sa i përket inspektimit të duhanpirjes, të gjitha analizave që kemi zhvilluar me inspektoriatin shtetëror shëndetësor, me ekspertët e Institutit të Shëndetit Publik, me të gjitha institucionet që japin sot të dhëna për ato çfarë kemi bërë dhe ato çfarë duhet të përmirësojmë, ne sjellim në këtë komision ndryshime që do të përmirësojnë me të vërtetë disa indikatorë të rëndësishëm deri në vitin 2023, për sa i përket prevalencës së duhanpirjes.

Çfarë propozojmë të ndryshojmë, konkretisht? Në ligjin aktual janë shumë pak të përfshira, për të mos thënë aspak, produktet novatore të duhanit. Në ligjin “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, duhani konvencional është i vendosur në tërësi si element kyç në kontrollet, në monitorimin, në mekanizmat e në të gjitha ato elementë ku kontrollohet ky aspekt. Ndërkohë, e gjithë pjesa e lënë jashtë, por që në direktivat e BE-së ekziston, e që Organizata Shëndetësore e Shëndetësisë e jep si një element të rëndësishëm për t'u përfshirë nëpër legjislacionet kombëtare, janë pikërisht produktet novatore.

Cigarja elektronike, duhani me ngrohje apo shishat, nargjiletë nuk janë të përcaktuara dhe nuk janë të definuara në legjislacionin aktual. Prandaj, nisur nga këto vakuume që ekzistojnë, nisur nga vullneti që kemi për ta orientuar vëmendjen tonë drejt gjithë aspekteve të përmirësimeve ligjore, përfshirë dhe duhanin jokonvencional, që përmenda më sipër, në ndryshimet ligjore të propozuara sjellim një seri përkufizimesh të duhanit e nënprodukteve të tij, dhe përfshijmë kategori të reja, të cilat synojnë pikërisht të përfshijnë në këtë kuadër rregullator çdo produkt apo nënprodukt duhani, që është i dëmshëm për shëndetin e popullatës.

Gjithashtu, nëpërmjet këtyre saktësimeve që propozohen, synohet forcimi i kontrollit të duhanit dhe të shmangen abuzimet. Më konkretisht, do të ndalohet duhanpirja në ambientet e brendshme edhe për duhanin me ngrohje, cigaren elektronike, shishat apo nargjiletë.

Për cigaren elektronike kemi vendosur limite që lidhen me përqendrimin e nikotinës, si dhe sasisë së lëngut me përmbajtje nikotine, me qëllim mbrojtjen e mëtejshme të konsumatorit nga kjo substancë që krijon varësi.

Do të ndalohet shitja e produkteve të duhanit me shije karakteristike, mente, vanilje e të tjera, si dhe shitja e paketave të duhanit me numër të reduktuar cigaresh, si masë që vlen për të dekurajuar duhanpirjen, kryesisht tek të rinjtë.

Aktualisht, në treg ekzistojnë produkte duhani, të cilat promovohen si më të pëlqyeshme nga konsumatorët, për shkak të shijeve shtesë që ndodhen në produkte, që në fakt trajtojnë kategori të caktuara konsumatorësh, veçanërisht adoleshentët, të rinjtë, gratë dhe vajzat.

Njësoj si me paketat me numër tub reduktuar cigaresh, prezenca në treg e këtyre produkteve rrit artificialisht prevalencën e duhanpirjes, ndaj ne kemi vendosur të ndalojmë tregtimin e tyre, duke vendosur patjetër një kohë të përshtatshme të heqjes nga tregu të këtyre dy llojeve të duhanit, atij me shije dhe paketimeve nën dhjetë cigare, gjë të cilën e kemi diskutuar edhe me grupet e interesit.

Afatet kohore janë konsultuar, pasi kemi pasur edhe diskutime me grupet e interesit, dhe kemi vendosur të jemi konform direktivës së Bashkimit Europian për sa i përket periudhës kohore dhe afateve që kërkon zbatimin e këtyre ndryshimeve.

Një tjetër pikë e rëndësishme është detyrimi që ne po u vendosim importuesve dhe prodhuesve të produkteve të duhanit, për të informuar Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me hyrjen në treg të produkteve të reja të duhanit, karakteristikave të tyre, si dhe të efekteve negative që kanë në popullatë, gjë e cila do të bëjë të mundur një monitorim shumë më të mirë të zbatimit të ligjit dhe përshtatjes së tij në të ardhmen, bazuar në produktet e reja që hyjnë në vend.

Gjithashtu, nëpërmjet ndryshimeve që propozojmë në këtë ligj, forcojmë masat për promocionin dhe marketingun e produkteve të duhanit, duke ndaluar edhe promocionin e fshehtë të këtyre produkte, sepse OBSH e konsideron faktor që stimulon përdorimin e tij në popullatë.

Aktualisht, me ligjin që kemi, në Shqipëri nuk është e lejuar të promovohet produkti i duhanit. Gjithsesi, studimet raportojnë se 92 % e shqiptarëve janë ekspozuar të paktën një herë ndaj promocionit të produkteve të duhanit.

Ka një debat në lidhje me produktet e reja, debat të cilin e kemi pasur edhe përgjatë konsultimeve të këtyre ndryshimeve ligjore, sepse sigurisht, industria e duhanit po i promovon produktet novatore si një alternativë më pak e dëmshme se duhani konvencional, por dhe si një mjet që mund t'i ndihmojë duhanpirësit për të mos konsumuar më shumë duhan. Referuar OBSH-së, vlen të referohet këtu, se pavarësisht faktit se produktet inovative të duhanit, si cigarja elektronike apo cigarja me ngrohje janë më pak të rrezikshme se produktet konvencionale të duhanit, nuk ka mjaftueshëm evidencë shkencore, që të mbështesë përdorimin e tyre si mjet ndihmës për të lënë duhanpirjen nga përdoruesit e duhanit. Përkundrazi, pavarësisht se këto produkte nuk çlirojnë të njëjtën sasi tymi dhe gazi të dëmshëm, ato përmbajnë sasi të larta nikotine, e cila është substancë që kërkon varësi.

Me ndryshimet që ne propozojmë, njësoj si për duhanin do të ndalohet dhe shitja e cigares elektronike, shishave, nargjileve, për personat nën 18 vjeç, sepse personat që u përkasin kategorisë 16-18 vjeç quhen ende fëmijë, si dhe do të ndalohet shitja e këtyre produkteve në institucione arsimore sportive, makina shitëse automatike e të tjera.

Një pikë tjetër, që e konsiderojmë tejet të rëndësishme, e dalë nga puna në praktikë e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, por edhe e institucioneve të tjera, të cilat kontrollojnë dhe zbatojnë ligjin, është pikërisht mbrojtja e konsumatorit nga produktet e duhanit, që ka për synim të forcojë implementimin e ligjit, si dhe që ka për synim të forcojë pikërisht masat administrative ndaj shkelësve të ligjit.

Është vënë re edhe nga inspektimet periodike të Inspektoratit të Shtetëror Shëndetësor ka ende subjekte, të cilët, pas marrjes së masave administrative nga inspektorët, vijojnë të kenë përsëri shkelje. Shkeljet në mënyrë të vazhdueshme vijojnë të trajtohen njësoj nga ligji me masa administrative të përcaktuara, duke mos pasur një përshkallëzim për shkelësit, të cilët janë në periodicitet në shkelje të ligjit. Ndaj, kemi vendosur të forcojmë masat administrative, duke vendosur që nëse një subjekt e shkel ligjin në një afat 3-mujor më shumë se sa dy herë, atëherë gjoba do të dyfishohet dhe, nëse një subjekt brenda një viti e shkel ligjin në mënyrë të përsëritur, gjoba do të gjashtëfishohet dhe do të shkojë deri në pezullim apo heqje të licencës së këtij subjekti, i cili konstatohet në shkelje të ligjit. Forcimi i kësaj mase konsiderohet shumë i nevojshëm pikërisht në kuadër të strategjisë për kontrollin, parandalimin, por edhe për marrjen e masave, të luftës që ne po bëjmë kundër duhanpirës, dhe besojmë se nëpërmjet këtyre masave qëllimi përfundimtar nuk është gjoba.

Së pari, synim është parandalimi dhe forcimi i masave i shërben parandalimit dhe masave që do të merren për shkelësit e përsëritur të ligjit për sa u përket këtyre kontrolleve që kryhen nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Pra, ndryshimet, që ne propozojmë dhe sjellim

sot për diskutimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji, vijnë pas një sërë konsultimesh, pas disa përmirësimeve që ne i kemi realizuar draftit të parë, që e kemi konsultuar me grupet e interesit nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme dhe përafrimit të legjislacionit me direktivën europiane të vitit 2014, me mbështetjen në marrëveshjen kuadër të lidhur me Organizatën Botërore të Shëndetësisë për kontrollin e duhanpirjes dhe në funksion të përmirësimeve në terren të asaj çfarë ne kemi konstatuar nga zbatimi i ligjit aktual.

Dua të theksoj se Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, pavarësisht diskutimeve që kemi pasur kryesisht me ato subjekte që tregtojnë duhanin, ka qenë shumë strikte në mbajtjen e një qëndrimi, që i shërben interesit të qytetarëve në funksion të ruajtjes dhe kujdesit për shëndetin.

Ky ishte një prezantim i shkurtër i ndryshimeve ligjore që ne propozojmë në kuadër të ligjit “Për forcimin e masave kundër duhanpirjes”, në funksion të përmirësimit të kujdesit të shëndetit të qytetarëve, ndaj një faktori risku, siç është duhani, i cili shkakton, qoftë sëmundshmëri, qoftë vdekshmëri dhe invaliditet në popullatë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka relatorja, zonja Bode.

Edlira Bode – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Nuk kam çfarë t’u shtoj të gjitha atyre që tha zonja ministre dhe nuk është nevoja që t’i përsëris. Pa dyshim, duhanpirja është një problem i rëndësishëm që afekton shëndetin publik, është faktor kryesor për shumë sëmundje kronike, të cilat sjellin rritje të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në vend. Ndryshimet, që propozon ministria në këtë projektligj, kanë qëllim kufizimin e reduktimin e duhanpirjes, si dhe forcimin e monitorimit nga ana e Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror të nivelit të zbatimit të ligjit kundër duhanit.

Ne sot kemi miratimin në parim dhe ju ftoj që ta miratojmë të gjithë në parim projektligjin, më pas gjatë kalimit nën për nen, ndoshta, do të kemi pika të veçanta, ku mund të bëjmë diskutime dhe ndërhyrje, por do t’i bëjmë kur të vijë momenti.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Bode!

Besoj se Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale është në dijeni që Organizata Botërore e Shëndetësisë është shumë sensitive ndaj ligjit për duhanin. Kam pasur një telefonatë dhe reagime nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në lidhje me duhanin. Besoj se mendimet e tyre janë të integruara në projektligjin apo në ndryshimet që vijnë në ligjin për duhanin.

Gjithashtu, theksojmë se 30% e vdekjeve në Shqipëri kanë si shkak duhanpirjen. Në qoftë se numërojmë se në Shqipëri janë 20 mijë vdekje në vit, 6 mijë të vdekur i dedikohen duhanpirjes. Ndërkohë që kanceri pulmonar ka si shkak kryesor duhanpirjen. Kështu që ka rëndësi lufta kundër duhanit, dhe kuptohet që duhet ulur prevalenca.

Në Shqipëri vihet re një rënie e lehtë e prevalencës në meshkuj, por rritje e prevalencës së përdorimit të duhanpirjes në femra. Kështu që duhet të ndërmerren më shumë politika ndërhyrëse në shkolla. Besoj se ligji ndihmon më së shumti që prevalenca e duhanpirjes të ulet. Ashtu siç e tha edhe zonja Ministre, besoj se është një objektiv shumë i fortë për të kapur në vitin 2023 rënien në 30% të duhanpirjes. Në qoftë se arrijmë këtë, atëherë kemi arritur një sukses. Megjithatë, kjo mbetet për t'u parë. Natyrisht, nuk është vetëm Ministria e Shëndetësisë, por është një qasje multisektoriale, shoqëria, rinia, shkolla dhe mjedisi janë në fokus kundër luftës të duhanpirjes për të ulur dhe për të mbrojtur shëndetin e njerëzve jo vetëm të atyre që e pinë, por edhe duhanpirjen pasive, e cila është aq e rrezikshme, sa edhe duhanpirja aktive. Njëkohësisht, sot flitet jo vetëm për duhanpirjen sekondare, por ka edhe një duhanpirje tjetër sekondare, e cila është duhanpirja në mjediset e shtëpisë, ku një duhanpirës jeton, edhe mobilet pas një kohe të gjatë reflektojnë efekte shëndetësore negative te njerëzit. Kështu që problematika e duhanit është shumë sensitive dhe unë mendoj që ky ligj duhet të kalojë. Në ditët në vazhdim ne kemi seancë dëgjimore me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, të cilët do të vijnë këtu dhe besoj se do të ndikojnë për të përmirësuar ligjin drejt objektivave të komunitetit europian apo të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Ndërkohë, kush ka pyetje, mund t'i bëjë.

Klodiana Spahiu - Zonja Ministre, faleminderit për prezantimin!

Në fakt, unë dhe Edlira kemi qenë pjesë e disa tryezave të bëra edhe me grupet e interesit, e cila ka qenë një eksperiencë shumë e mirë, edhe për t'u informuar përpara kalimit të këtij projektligji, që të jemi sa më korrektë edhe me grupet e interesit. Dua thjesht të transmetoj një shqetësim të tyre. Si mund të arrijmë ne të fenojmë shitjen informale, shitjen në rrugë, shitjen me cigare të hapura dhe shitjen në ambiente jo të caktuara për duhanin, apo duhanin e hapur, sepse, me të drejtë, ata pretendojnë që ky duhan që shitet në mënyrë të pakontrolluar është shumë më i dëmshëm sesa duhani që shitet në vende të caktuara dhe të miratuara?

Së dyti, dua t'ju përgëzoj, ashtu siç tha edhe kryetari, sepse kjo është një sfidë dhe një luftë e përditshme jo vetëm e ministrisë, por e secilit prej nesh. Kudo që jetojmë, kudo që punojmë, duke filluar nga ky institucion në të cilin punojmë, duhet të jemi korrektë, të zbatojmë ne të parët ligjin dhe më pas t'u kërkojmë të tjerëve të zbatojnë ligjin.

Faleminderit!

Halit Valteri- Halit Valteri, Grupi Parlamentar Demokrat.

E nderuara Ministre,

Në projektligjin e sjellë për konsultim ju parashikoni që shitja e produkteve të duhanit do të bëhet vetëm në pikat e autorizuara, jo në çdo dyqan, sepse këtu jetojmë në vendin e çudirave, ku mund të gjejmë edhe në furrën e bukës që shiten cigare. Këtu është për të vënë duart në kokë. Pse në variantin që keni sjellë në Kuvend kjo pikë është hequr dhe sa ndikon kjo në stimulimin e duhanpirje? A ka pasur indicie nga biznesi i vogël që është hequr kjo pikë? Nëse ne do t'ia vështirësojmë punën një grupmoshe të caktuar, që ta bëjmë siç e ka gjithë bota me “makineta”, ku duhet të kesh një kartë identiteti, sepse të gjithë mbi 18 vjeç kanë një ID, nën 18 vjeç nuk ka ID, e fut atje dhe merr cigare, e ke më të kontrolluar këtë pjesë. Mendoj se 500 apo 600 tabakino që janë shtuar në Tiranë nuk kërkojnë kartë identiteti dhe moshën për të blerë një paketë cigare. Kështu që mendoj që duhet më shumë punë te kjo pjesë.

Faleminderit!

Ogerta Manastirliu -Po e filloj nga pyetja e dytë. Është e vërtetë që drafti i parë ka pasur një pikë, ku propozohej që Ministria e Shëndetësisë të ishte organi që të jepte licencat për sa i përket shitjes së autorizuar të duhanit. Më pas kemi pasur disa tryeza konsultimesh me grupet e interesit, ku kemi referuar dhe jemi mbështetur edhe në praktikën ndërkombëtare sesi aktualisht vendet e BE-së apo edhe më gjerë i kanë parashikuar pikërisht këto elemente, të cilat sigurisht orientojnë shumë kontrollin e dedikuar sa u përket parametrave që ne kontrollojmë duhanin, por nga ana tjetër është vlerësuar edhe nga grupet e interesit, por edhe pas një analize që vetë ne si Ministri e Shëndetësisë realizuam, që vendosja apo dhënia e licencës vetëm për një kategori të caktuar ose për një element të caktuar është e parakohshme si masë, por kjo nuk do të thotë se ligji që ne sjellim sot, apo ndryshimet që sjellim sot ne për miratim dhe ligji aktual nuk kanë të parashikuar kontrollin për sa u përket atyre elementeve që ligji sot parashikon në raport me shitjen e duhanit, i cili është i ndaluar për grupmoshën nën 18 vjeç dhe, në këtë aspekt, ligji lejon Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor që të bashkëpunojë me inspektoratet e tjera, edhe me institucionet e tjera, përfshirë Drejtorinë e Tatim Taksave, doganat, Policinë Bashkiake, Inspektoratin e Punës dhe të Arsimit në mënyrë që të bashkëpunojnë në grupe të përbashkëta ndërsektoriale pikërisht për të monitoruar zbatimin e ligjit. Pra, e para gjë që ne duhet të bëjmë është zbatimi rigoroz i ligjit dhe ndryshimeve ligjore që propozojmë, të cilat me të vërtetë do të sjellin një ndryshim për sa u përket masave që ne do të ndërmarrim, të cilat janë masa goxha të mira për sa i përket qëllimit final, që është ulja e prevalencës nga duhanpirja dhe ulja e numrit të përdoruesve të duhanit, por, mbi të gjitha, edhe

mënyra sesi ne po veprojmë për sa i përket parandalimit. Qëllimi i çdo mase që ne sot po përfshijmë në këtë ligj është pikërisht parandalimi. Edhe rritja e vlerave të gjobës, edhe marrja e masave për sa i përket përfshirjes së ndalimit të duhaneve, të cilët konsiderohen si produkte inovatore të duhanit, shkojnë pikërisht në këtë qëllim, në parandalim dhe sigurisht kontroll më të mirë të produkteve të duhanit. Është vlerësuar si e parakohshme kjo masë, por nuk do të thotë që nuk mbetet në objektivat tona, sepse ne nuk duam të vendosim një masë, e cila më vonë do të rrisë informalitetin apo shitjen nën tavolinë të duhanit. Pra, ne duam të vendosim masa të cilat me të vërtetë arrijmë t'i zbatojmë. Nuk duam që të vendosim apo të miratojmë ligje, të cilat më pas të na përkthehen jo të zbatueshme. Sigurisht që drafti i parë mund të ishte ideali, por më pas, i përkthyer në kontekstin tonë dhe në instrumentet tonë të monitorimit dhe të kontrollit, ne vendosëm që të përcaktojmë masat, të cilat janë të arritshme në ambientin dhe në kontekstin tonë. Pa dyshim këto masa përafrojnë këtë ligj me direktivën europiane, dhe, gjithashtu, me marrëveshjen kuadër të kontrollit të duhanit, që ne kemi ratifikuar në parlament nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe një element, që besoj se është shumë i rëndësishëm për ta theksuar, është që progresraporti i fundit i Komisionit European na ka mbështetur dhe na ka vlerësuar në një element tejet të rëndësishëm për sa i përket luftës që Shqipëria ka bërë dhe zbatimit të mirë të ligjit “Për duhanin”, pra për kontrollin ndaj produkteve të duhanit dhe masave që ka marrë.

Pavarësisht se progresraporti ka bërë këtë vlerësim pozitiv, ne nuk jemi të kënaqur, nuk biem në vetëkënaqësi, por po ndërmarrim masa të mëtejshme për ta përafuar legjislacionin tonë me atë të Bashkimit European dhe, gjithashtu, për t'i forcuar masat, në mënyrë që të parandalojmë duhanpirjen te moshat e reja dhe të forcojmë masat e kontrollit për sa i përket duhanpirjes në ambientet e mbyllura, gjë që vijon të monitorohet dhe të inspektohet nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kemi pasur edhe pika të dobëta, ku, le të themi, të vërtetën, nuk kemi arritur dot të ndërhyjmë në kohë, pikërisht sepse ligji parashikonte vetëm vendosje gjobe.

Ndërkohë, nëse ne shkojmë në mënyrë të përsëritur te subjekti, i cili e shkel ligjin herë pas here brenda një viti, ndaj tij do të merret masa më drastike: do t'i hiqet licenca.

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Ministre!

Natyrisht, komisioni do ta shqyrtojë ligjin edhe nën për nen, por do të ketë edhe takimet me grupet e interesit dhe OBSH-në, që i fillojmë të premtën. Ndaj, pa humbur kohë, ju ftoj ta kalojmë ligjin në parim.

Kush është dakord në parim?

(Diskutime në sallë)

Anëtarët e komisionit të rrinë, sepse duhet të shqyrtojmë një kërkesë që i ka ardhur komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pas miratimit në parim të projektligjit për disa ndryshime në luftën kundër duhanit, në komision ka ardhur një kërkesë nga një qytetar i Proçanit të Gramshit, i cili ka dy fëmijë me distrofi muskulare (diagnoza është e konfirmuar) dhe kërkon ndihmë nga ne për ta trajtuar jashtë shtetit.

Natyrisht, ne nuk kemi kompetencë ta dërgojmë jashtë shtetit, por unë ju ftoj që këtë kërkesë të qytetarit, në emër të komisionit, t'ia adresojmë Ministrisë së Shëndetësisë për ta shqyrtuar dhe për ta marrë parasysh, duke na informuar në të ardhmen se çfarë ka bërë me qytetarin në fjalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoje se ju bini dakord që t'i drejtohem Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në kërkesën e qytetarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Biem dakord të gjithë?

(Diskutime në sallë)

Qytetari e ka bërë kërkesën në QSUT, e ka shkruar këtu, është trajtuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka aplikuar më përpara, ka shkruar në Ankara vitin e kaluar, ku është trajtuar, por i duhet të shkojë edhe një herë. Tani kërkon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta procedura për ta parë...

Ne i drejtohem Ministrisë së Shëndetësisë. Në kërkesë janë përshkruar të gjitha procedurat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Stojku – Çuditërisht turqit nuk e pranuan marrëveshjen që ne kishim nënshkruar, duke zgjedhur variantin e 300 pacientëve në vit. Duke qenë se ne kishim kaluar mbi 1000 pacientë për rreth 2 vjet, ata u rikthyen dhe na thanë: e keni tejkaluar normën.

Unë mendoj që mos të jetë thjesht kuota, por duhet vënë në dijeni ministrija personalisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo sektorin përgjegjës, se puna e sektorit është krejt e parëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fund të fundit, sektori drejton aspektin administrativ e të tjera. Prandaj duhet të flasësh me ministren. Nuk mund t'i jap unë mendim as ministrisë, as ministres, por do të ishte mirë që ministrja të organizojë një takim me vëllezërit tanë turq që marrëveshja kuadër, që ne e kemi pasur për 300 pacientë në vit, le të rikthehet në normativën e periudhës 2007-2009, që ata të mos na vënë numra të kufizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E bëjnë ata. Nëse ministrja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe punën e hemodializës e kam ndjekur vetë dhe e di situatën tërësisht në të gjithë terrenin. Problemi është këtu: nëse ministrja vepron politikisht, nuk është fare çudi të ndodhë kjo që them unë. Përndryshe, po mbetëm në kuotën e 300-ës, kot që bëjmë kërkesa, kot që lodhemi, kot që mbushim shkresa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Ne t'ia kërkojmë Ministrisë së Shëndetësisë, pastaj kjo e fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Stojku – Prandaj po them. Këtë bëje si bisedë ti vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Vetë ia kemi bërë, por edhe si komision.

Edmond Stojku – Më mirë hipi avionit, i thuaj, shko me një grup pune, kërko një takim me ministrin e Shëndetësisë në Turqi, rri dy ditë atje, se nuk bëhet nami...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm kështu zgjidhet. Mbage mend çfarë po të them, sepse me dokumentacion do të kesh atë përgjigjen e thatë elektronike: “Kuota është plotësuar dhe nuk kemi çfarë të bëjmë”.

Enver Roshi – Ne sugjerim e kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Stojku – Unë po ta them sinqerisht në kuptimin nëse do ta realizosh vërtet. Nëse do të mbushim letra...

Klodiana Spahiu – Në vijim të kolegut parafolës, mendoj që në qoftë se do të zgjedhim një individ, nuk e zgjidhim problemin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përditë na vijnë raste të tilla që e kanë bërë një herë procedurën, duan të shkojnë ta përsërisin dhe jemi gjithnjë përballë këtij fakti. Mund të kërkojmë një takim informal me ministren dhe t'ia themi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është mirë të ketë një zgjidhje, sepse, të jemi koshientë, numri është rritur realisht shumë dhe ndoshta ka një limit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Unë mendoj që t'ia dërgojmë Ministrisë së Shëndetësisë dhe pastaj i vazhdojmë hapat e tjerë me ministrinë.

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ia them.

Atëherë, biem dakord t'ia dërgojmë Ministrisë së Shëndetësisë rastin e këtij hallexhiut?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit të gjithëve!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA